



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 52

Tiranë – E mërkurë, 29 mars 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 129, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.....	6173
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 130, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.....	6175
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 131, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	6177
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 132, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.....	6179
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 133, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.....	6181
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 134, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.....	6183
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 135, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.....	6185
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 136, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.....	6187
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 137, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.....	6189
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 138, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.....	6191
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 139, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.....	6191

Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 140, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.....	6192
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 141, datë 28.3.2023	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.....	6192



VENDIM
Nr. 129, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është në Peshkopi, në adresën: Rruga, “Tercilio Kardinali”, Peshkopi 8301.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR**

Neni 2
**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

SEKSIONI III
ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 3
Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të Komisionit të Ristrukturimit cakton Kancelarin në



detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4

Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5

Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Dibër dhe Mat deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6

Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7

Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbyll të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Neni 8

Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM
Nr. 130, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është në Durrës, në adresën: Lagja nr.2, Rruga “Aleksandër Goga”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS**

Neni 2
**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

4. Pozicionet e shpallura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilat në datën 1.5.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e lëvizjes paralele, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Këshilli i Lartë Gjyqësor pas datës 1.5.2023 vijon procedurat e papërfunduara për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

SEKSIONI III
ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 3
Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm



Durrës, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit.

4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykatë, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rrethit gjyqësor Durrës dhe Kavajë deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjyqësor.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 8 Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM
Nr. 131, datë 28.3.2023

PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është në Fier, në adresën: Lagja “29 Nëntori”, Rruga: “Todi Shkurta”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

Neni 2
Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

SEKSIONI III
ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR

Neni 3
Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.



4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Fier dhe Lushnjë deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit,

transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Neni 8 Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM

Nr. 132, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është në Gjirokastrë, në adresën: Lagja “18 Shtatori”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II

**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR**

Neni 2

**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

SEKSIONI III

**ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR**

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.



4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Gjirokastrë dhe Përmet deri në

datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomik financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Neni 8 Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM
Nr. 133, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
LEZHË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është në Lezhë, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
LEZHË

Neni 2

Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

SEKSIONI III
ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.



4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Kurbin deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit,

transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomik financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Neni 8 Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM

Nr. 134, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

**SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është në Korçë, në adresën: Lagja nr.3, Rruga “Nënë Tereza”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II

**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË**

Neni 2

**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

SEKSIONI III

**ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR**

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.



4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 **Administrata gjyqësore**

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 **Transferimi i çështjeve gjyqësore**

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rrethit gjyqësor Korçë dhe Pogradec deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit,

transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 **Menaxhimi i çështjeve gjyqësore**

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 **Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Neni 8 **Hyrja në fuqi e vendimit**

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM
Nr. 135, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KUKËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është në Kukës, në adresën: Sheshi “Skënderbej”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KUKËS

Neni 2

Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

SEKSIONI III
ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve



kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të Komisionit të Ristrukturimit cakton Kancelarin në detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 **Administrata gjyqësore**

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 **Transferimi i çështjeve gjyqësore**

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rrethit gjyqësor Kukës dhe Tropojë deri në datën

30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 **Menaxhimi i çështjeve gjyqësore**

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 **Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomik financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Neni 8 **Hyrja në fuqi e vendimit**

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM
Nr. 136, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është në Shkodër, në adresën: Rruga “Don Bosko”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR**

Neni 2

**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

SEKSIONI III
**ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR**

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit.



4. Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të Komisionit të Ristrukturimit cakton Kancelarin në detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4

Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5

Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër e Pukë deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit,

transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6

Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7

Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Neni 7

Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami



VENDIM

Nr. 137, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë fillon funksionimin më datë 1.5.2023.

3. Selia e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është në Tiranë, në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.4.2023.

SEKSIONI II

**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Neni 2

**Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Pozicionet e shpallura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilat në datën 1.5.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e lëvizjes paralele, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këshilli i Lartë Gjyqësor pas datës 1.05.2023 vijon procedurat e papërfunduara për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

SEKSIONI III

**ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR**

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm



Tiranë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit.

4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykatë, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, nuk ndryshon përbërjen aktuale të tij.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4 **Administrata gjyqësore**

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5 **Transferimi i çështjeve gjyqësore**

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Krujë deri në datën 30.4.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve Ark-IT.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6 **Menaxhimi i çështjeve gjyqësore**

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7 **Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda muajit maj 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja më datë 30.4.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Neni 8 **Hyrja në fuqi e vendimit**

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

**VENDIM****Nr. 138, datë 28.3.2023****PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
BERAT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. S115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023, me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me seli në adresën: Rruga “Antipatrea”, Lagja “Iliria”, Berat.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami**

VENDIM**Nr. 139, datë 28.3.2023****PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me seli në adresën: Lagja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami**



VENDIM

Nr. 140, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SARANDË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me seli në adresën: Lagja nr.1, Rruga “Onhezmi”, Godina 69, Sarandë.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

VENDIM

Nr. 141, datë 28.3.2023

**PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me seli në adresën: Lagja “Hajro Çakëri”, Rruga “Sulejman Delvina”, Vlorë.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë